

Skema e Pensioneve me Kontribute të Përcaktuara, Sfidat e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri

***Astrit Hado**

Social Insurance Institute, Albania, hadoastrit@yahoo.com

Abstrakt

Zhvillimi i sistemeve të mbrojtjes sociale në përgjithësi dhe i sigurimit shoqëror në veçanti përbën një nga prioritetet e zhvillimit shoqëror në vendin tonë. Shumica e sistemeve të sigurimit të pleqërisë sot janë të qeverisura në mënyrë publike, dhe paguajnë “përfitime të përcaktuara” (DB) në bazë të formulave që bazohen në pagat e punonjësve, vitet e shërbimit etj. dhe financohen nga kontributet e atyre që paguajnë sot, në bazë të sistemit “pay as you go” (PAYG). Por sistemet ekzistuese jo gjithnjë janë në gjendje të mbrojnë në mënyrë të pranueshme të moshuarit e sotëm si dhe ato që do të moshohen në të ardhmen, dhe shpesh nisur nga çështjet fiskale, i kanë shpërndarë përfitimet në mënyrë të pabarabartë, duke krijuar “padrejtësi” dhe pengesa në rritjen ekonomike si pasojë e kthimit të skemës së pensioneve në rënduesin kryesor të defiçitit. Sistemi i Sigurimeve Shoqërore të detyrueshme dhe në përgjithësi sistemi i mbrojtjes shoqërore në Shqipëri, si edhe në vendet e tjera, është i ndikuar nga fuqia ekonomike e vendit, zhvillimet e tregut të punës, situata demografike, situata e punësimit dhe papunësia, zhvillimi i prodhimit të brendshëm bruto, stabiliteti makroekonomik e fiskal etj.

Presionet demografike si rënia e lindshmërisë, rritja e jetëgjatësisë së qytetarëve, emigracioni masiv i krahut të punës si dhe problemet ekonomike në nivel strukturor në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë do të krijojnë një vështirësi në skemën publike të pensioneve.

Vështirësitë do të jenë në dy kahe, në defiçitin e madh të skemës publike duke rrezikuar qëndrueshmërinë financiare të skemës dhe në shkallën e ulët të zëvendësimit për përfituesit. Masa e pensionit do të jetë e ulët duke mos garantuar qëllimin e ekzistencës së skemave të pensionit, zëvendësimin e të ardhurave nga puna dhe zbutjen e varfërisë në moshën e tretë.

Fjalë kyçe: Sistemi i Sigurimeve Shoqërore, Skema e Sigurimeve, Mbrojtja Shoqërore

JEL Codes: G22; G52.

* Autori korrespondent

Abstract

The development of social protection systems in general and social insurance in particular is one of the priorities of social development in our country. Most old-age insurance systems today are publicly governed, and pay "defined benefit" (DB) based on formulas according the employee salaries, insured periods etc. and are funded by the contributions of those who pay today, under the PAYG system. But the existing systems are not always able to adequately protect today's elderly as well as those who will grow old in the future, and often due to fiscal issues, they have distributed the benefits unequally, creating "unfairness" and obstacles to economic growth as a result of the return of the pension scheme to the main deficit aggravator.

The mandatory Social Insurance System and in general the social protection system in Albania, as well as in other countries, is influenced by the economic power of the country, labor market developments, demographic situation, employment situation and unemployment, development of gross domestic product, macroeconomic and fiscal stability etc.

Demographic pressures such as declining fertility, increasing the life expectancy of citizens, massive labor migration as well as economic problems at the structural level in the short and long term, will create a difficulty in the public pension scheme.

The difficulties will be in two directions, in the large deficit of the public scheme endangering the financial sustainability of the scheme and in the low rate replacement for the beneficiaries. The pension amount will be low by not guaranteeing the purpose of the existence of pension schemes, replacement of income from work and poverty alleviation in old age.

Key words: Social Insurance System, Insurance Scheme, Social Protection

JEL Codes: G22; G52.

1. Hyrje

Zhvillimi i sistemeve të mbrojtjes sociale në përgjithësi dhe i sigurimit shoqëror, në veçanti përbën një nga prioritetet e zhvillimit shoqëror në vendin tonë. Në funksion të paqes sociale dhe mirqënies së individit, veprimtaria e shtetit punëdhënësve dhe individëve evidenton përpjekjet që nga ngritja e skemave të thjeshta të mbrojtjes shoqërore, deri në formulimin dhe zhvillimin e sistemeve komplekse të mbrojtjes sociale në përgjithësi dhe të sigurimit shoqëror në veçanti.

Eksperiencia e vendeve të zhvilluara ka dëshmuar se vendosja e një rrjeti të arsyeshëm të mbrojtjes shoqërore, rrit dhe zhvillon fuqinë punëtore të vendit dhe stabilitetin politik ekonomik e social.

Sistemet e ngritura janë përsosur e zhvilluar, kanë përballuar me sukses sfida të zhvillimeve ekonomiko shoqërore ndërkohë që janë ndeshur dhe vazhdojnë të ndeshen me një sërë problemesh mjaft të mprehta të zhvillimeve ekonomike, demografike, por edhe social-politike apo të menaxhimit. Shpesh këto problematika i kalojnë kufijtë e shteteve dhe rajoneve dhe evidentohen si tendenca më të gjera, zgjidhja e të cilave në fund të fundit duhet të mbajë parasysh veçoritë e zhvillimeve të çdo vendi, por edhe më gjerë.

Zhvillimet aktuale ekonomike, zhvillimet e pritshme, tendencat demografike si dhe mësimet që janë nxjerrë nga analiza e fenomeneve të krizës financiare të viteve të fundit evidentojnë domosdoshmërinë e ndërtimit të sistemeve të plota të sigurimit social (Pino. A., 2015) si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të gjithë personave në këto sisteme, të cilat nga njëra anë sigurojnë një mbrojtje sociale më cilësore dhe reduktim të barrës buxhetore dhe nga ana tjetër megjithëse në nivele më minimale , sigurojnë një mbrojtje sociale të sheshtë për të gjithë duke mos e larguar shtetin nga protagonizmi në këtë fushë, sepse në fund të fundit ajo është edhe një detyrë e funksionit të tij.

Sistemet shumëshyllëshe të mirëmenaxhuara dhe mirëmbikqyrura konsiderohen të jenë shumë elastike dhe mjaft të mbrojtura edhe ndaj turbullirave të mëdha financiare si edhe arrijnë të garantojnë një mbrojtje të gjerë dhe të qëndrueshme kundër varfërisë.

2. Sfondi teorik

Përgjithësisht në dialektiken zhvillimore të skemës së sigurimeve, në shumicën e vendeve ka mbizotëruar sistemi Pay As You Go (PAYG) (Bismark, 1889) në themel të të cilit qëndrojnë parimet e solidaritetit dhe vazhdimësisë së brezave, sistemi i cili mendohet se e kreu mirë funksionin e tij. Por shekulli i ri ka shtruar përpara këtij sistemi sfida të reja si qëndrueshmëria financiare e sistemit, shkalla e zëvendësimit, shkalla e mbulimit, rritja e jetëgjatësisë dhe rënia e lindshmërisë etj. Por në gjendjen aktuale dhe problematikën që çfaq Sistemi i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri pyetja shtrohet Si?, Cilat janë alternativat?, Kur ? A jemi të vonuar? Si mund të përfitojmë nga eksperiencat e të tjerëve? Cila është zgjidhja më e mirë për kushtet dhe gjendjen aktuale? etj.

Shumica e sistemeve të sigurimit të pleqërisë sot janë të qeverisura në mënyrë publike, dhe paguajnë “përfitime të përcaktuara” (Anita M. Schwarz, Omar S. Arias “The Inverting Pyramid, Pension Systems Facing Demographic Challenges in Europe and Central Asia” Publ. I World Bank, 2014)

bazë të formulave që bazohen në pagat e punonjësve, vitet e shërbimit etj. dhe financohen nga kontributet e atyre që paguajnë sot, në bazë të sistemit PAYG. Por këto sisteme ekzistuese jo gjithnjë janë në gjendje të mbrojnë në mënyrë të pranueshme të moshuarit e sotëm si dhe ato që do të moshohen në të ardhmen, dhe

shpesh nisur nga çështjet fiskale, i kanë shpërndarë përfitimet në mënyrë të pabarabartë, duke krijuar “padrejtësi” dhe pengesa në rritjen ekonomike si pasojë e kthimit të skemës së pensioneve në rënduesin kryesor të GDP.

Nje sistem qe optimizon risqet dhe qe konsiderohet si sistemi i se ardhmes eshte ai i perzier qe eshte pjeserisht me kontribute te percaktuara, te kapitalizuar dhe te administruar privatisht, te koordinuara me sistemin me perfitime totalisht te percaktuara PAYG dhe te administruara ne menyre publike (Holzmann, Robert. 2009. Aging Population, Pension Funds, and Financial Markets: Regional Perspectives and Global Challenges for Central, Eastern, and Southern Europe. Washington, DC: World Bank.)

Kështu do të mund të arrijmë në një sistem me përbërje tre kolonëshe:

- **Kolona e parë, e detyrueshme, e administruar në mënyrë publike** dhe e financuar nga kontributet, që ka për qëllim rishpërndarjen. Kjo kolonë krijon një rrjet mbrojtjeje shoqërore, veçanërisht për të moshuarit të ardhurat e të cilëve për të jetuar janë të ulta dhe quhet shkurtimisht PAYG.
- **Kolona e dytë, e detyrueshme, e administruar privatisht** dhe tërësisht e kapitalizuar, që mbulon objektivin e kursimeve. Ajo lidh përfitimet në mënyrë aktuariale me kontributet si në skemën me kontribute të percaktuara (DC), ajo është totalisht e kapitalizuar, kontributi është i detyrueshëm dhe administrohet në mënyrë konkurrese privatisht. Ndërtimi i kësaj kolone përbën një ndër pikat më të rëndësishme të reformave të ndërmarra në fushën e sigurimeve shoqërore.
- **Kolona e tretë, vullnetare** është e kapitalizuar me kontribut vullnetar dhe administrohet nga kompani private, shpesh konsiderohet edhe si skemë suplementare. Kjo kolonë është e përshtatshme për personat që duan më shumë përfitime financiare në pleqëri.

Aktualisht, sistemi i pensioneve në Shqipëri funksionon vetëm me dy kolona (Ligji 7703/1993), kolona e parë publike PAYG që financohet nga kontributet e detyruara dhe administrohet nga ISSH dhe kolona e tretë që financohen nga kontributet vullnetare dhe administrohen nga shoqëritë e administrimit të fondeve private të pensioneve.

3. Metodatat dhe procedurat

Objektivi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i mundësisë së ngritjes së kolonës së dytë në Shqipëri me kontribute të detyruara dhe të administruara privatisht.

Ky objektivi synohet të përmbushet duke evidentuar: strukturën e skemës trekolonëshe; mënyrat e ndërtimit të kolonës së dytë si edhe duke sygjieruar alternativat lidhur zhvillimin e një sistemi të plotë pensionesh dhe efektet e mundshme në sistem në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Duke konsideruar futjen e kolonës së dytë dhe sygjeruar ndërtimin e një skeme të perzier kemi synuar të vlerësojmë efektet në cdo kolonë në periudhë afatgjatë.

Llogaritjet mbi efektet janë bazuar në variante të studiuara më parë nga ISSH (Projeksion aktuarial i ISSH për ecurinë e skemës realizuar nëpërmjet programit PROST) dhe duke u bazuar në përlllogaritje të drejtpërdrejta duke vlerësuar gjendjen aktuale të pjesëmarrjes, normës së kontributeve, të të ardhurave etj (ISSH statistical Year Book 2019/main indicators).

4. Rezultate dhe diskutime

Shqipëria, me gjithë emigracionin mjaft të lartë, përsëri është një vend me shumë burime njerëzore. Aktualisht, Shqipëria ka një popullsi mesatarisht të re, në vitin 2021 moshë mesatare është 37.6 vjet nga 37.2 vjet që ishte vitin 2020, raporti i varësisë së të rinjve (raporti i popullsisë 0-14 vjeç me popullsinë 15-64 vjeç) u zvogëluar, krahasuar me 1 janar 2020, nga 24,6 % në 24,2 %, ndërsa raporti i varësisë së të moshuarve (raporti i popullsisë 65+ me popullsinë 15-64 vjeç) u rrit, nga 21,6 % në 22,3 % gjatë të njëjtës periudhë (INSTAT 2020). Të dhënat e mësipërme tregojnë që ka një rritje të shpejtë të numrit të të moshuarve. Rënia e numrit të lindjeve sidomos në vitet e fundit ka qenë shumë e madhe gjë që do të krijojë probleme në të ardhmen afatmesme përse i përket tregut të punës dhe kontributit në skemën publike. Gjatë vitit 2020, lindën 28.075 foshnja, duke pësuar një rënie prej 1,7 %, krahasuar me një vit më parë. Presioni i grupeve të interesit ndaj skemës publike për dalje parakohe në pension po rritet ndjeshëm duke mos zbatuar edhe parashikimet e dokumentit të politikave të pensioneve të vitit 2014.

Disa profesione të vështira dhe shumë të vështira kërkojnë daljen më herët se koha normale e daljes në pension duke krijuar deficit dhe deformim të parimeve që funksionon skema. Mund të përmendim minatorët e nëntokës, punonjësit e industrisë së naftës dhe metalurgjisë, aktorët e cirkut, teatrit të operas dhe baletit, orkestrave frymore etj.

Sistemi i përgjithshëm i Sigurimeve Shoqërore është pothuaj i gjithi përgjegjësi e shtetit. Janë aktualisht tre fonde pensionesh, të bazuara në kursimet pensionale të cilat ende janë të pazhvilluara dhe nuk kanë peshë në mbështetjen me të ardhura të popullsisë së moshuar.

Bazuar në formulën e pensionit në fuqi deri në 31.12.2014, **shkalla e zëvendësimit** pra raporti midis pensionit dhe pagës, në nivele mesatare, përlllogaritej të qëndroj mbi 30 % deri në vitin 2032 (Projeksion aktuarial ISSH, 2015) e më pas fillon të bjerë në mënyrë dramatike, duke shkuar nën 25 %. Ndryshimi i formulës së kalkulimit të pensionit, rregullat e përcaktuara të indeksimit të pensionit dhe të pagave dhe masa të tjera që parashikon reforma, përmirësim të shkallës së zëvendësimit, e cila mesatarisht arrin deri në 50 % të pagës ndërkohë që përcaktohet që ajo në periudha afatgjata të mos bjerë asnjëherë më poshtë se 30 %,

por që përsëri konsiderohet i ulët. Ndonëse ky pension nuk është shumë gjeneroz, ai përlogaritet që do t'i mbajë të moshuarit mbi nivelin e varfërisë e do të jetë edhe financiarisht i përballueshëm.

Nga sa argumentuam më sipër mbi parashikimet për zhvillimin e shkallës së zëvendësimit pension/pagë, si aktualisht edhe në të ardhmen “pakënaqësitë “ dhe “reagimet” për masën e ulët të pensionit do të vazhdojnë të jenë prezente ndërkohë që barra fiskale e shtetit për skemën e detyrueshme gjithmonë do të jetë e konsiderueshme, por me synimin që të mbahet në nivele të pranueshme.

Gjithashtu një sistem i alternuar, i proporcionuar mirë do të arrinte të shmangte problematikat e sistemit PAYG ku shpesh ka ndodhur të kenë shpërndarë përfitimet në mënyrë të pabarabartë midis brezave apo edhe të kenë penguar kështu rritjen ekonomike si pasojë e kthimit të skemës së pensioneve në konsumatorin kryesor të buxhetit. Nga ana tjetër, duke qenë se principialisht “barazimi i artë” se “ kundrejt kontributeve të njëjta duhet të ketë përfitime të njëjta”, *ata që dëshirojnë të ardhura shtesë apo edhe me përpara se të tjerët, do duhet të kursejnë më shumë, por kjo nuk përjashton nga përgjegjësia financiare punëdhënësin, i cili është themeli i përgjegjësisë si për të ardhurat nga puna ashtu edhe në lidhje me kursime për pleqërinë.*

a. Ndërtimi i kolonës (shtyllës së dytë).

Parimet mbi bazën e së cilave ndërtohet kolona e dytë, janë si më poshtë:

- **Ajo duhet të jetë e detyrueshme.** Arsyeja për këtë është qëndrimi i individëve – një numër i konsiderueshëm njerëzish mund të jenë dritëshkurtër, dhe të mos mendojnë për pleqërinë e tyre duke u bërë kështu një barrë për shoqërinë kur të plaken.
- **Me kontribute të përcaktuara (DC).** Lidhja e ngushtë e përfitimeve me kontributet shmang evazionin kontributiv, sa më shumë kontribute, aq më shumë përfitime. Pensioni llogaritet në mënyrë aktuariale mbi bazën e moshës dhe akumulimeve të individit, dhe kjo mund ta shtyjë daljen e parakohshme në pension dhe ta rrisë moshën e daljes në pension kur rritet jetëgjatësia.
- **Totalisht e kapitalizuar:**
 - a) *Së pari*, kjo e bën koston të qartë që në fillim;
 - b) *Së dyti*, kjo mënyrë eviton rritje të kontributeve të domosdoshme në sistemet PAYG kur popullsia plakët;
 - c) *Së treti*, kjo mënyrë parandalon transferimin ndërmjet brezave prej të rinjve tek të vjetrit;
 - d) *Së katërti*, kapitalizimi shërben për të ngritur kursime kombëtare në terma afatgjatë;
- **E administruar në mënyrë private.** Kjo maksimizon faktin që objektivat ekonomike dhe jo ato politike përcaktojnë strategjinë e investimeve. Në këtë mënyrë administrimi privat do të zgjedhë alokimin më të mirë të kapitalit dhe

fitimin më të lartë mbi kursimet dhe gjithashtu ndihmon vendin në zhvillimin e tregjeve financiare. Fondet private zakonisht investojnë në një mikso bono publike dhe të korporatave, equities dhe pasuri të patundshme dhe kanë një shkallë të lartë fitimi. Ato mund të shfrytëzojnë edhe diversifikimin internacional, që bën të mundur interesa më të larta dhe risk më të reduktuar. Ato nxisin gjithashtu zhvillimin e tregut financiar, duke krijuar një kërkesë për instrumente dhe institucione të rinj financiare.

b. Probleme që duhen marrë në konsideratë

Menaxhimi dhe financimi i tranzicionit. Kalimi në sistemin me shumë kolona pothuajse gjithmonë kërkon burime shtesë.

Financimi i borxhit. Në teori, buxheti i çdo vendi reflekton jo vetëm borxhin e tij formal, por edhe borxhin e tij implicit për pensionet. Mbulimi i borxhit implicit për pensionet ka koston e vetë financiare. Teorikisht gjenden dy alternativa.

- **Rritja e masës së kontributit për pensione.** Një vend mund të zgjedhë të financojë një pjesë ose të gjithë koston e tranzicionit duke ngritur në total masën e kontributit, por kjo ka pasur për pasojë rritjen e informalitetit në shumë vende, si rrjedhim kostoja e kolonës së dytë duhet të mbulohet brenda masës ekzistuese të kontributit.
- **Reduktimi i shpenzimeve në kolonën e parë.** Disa axhustime në nivelin e përfitimeve të kolonës së parë (shkalla e zëvendësimit, indeksimi, dhe mosha e daljes në pension) mund të jenë të nevojshme për ta sjellë atë në balancë, së bashku me shpresën për një rritje në pjesëmarrjen e forcave të punës. Këto axhustime duhen bërë edhe nëse nuk ka kolonë të dytë. Efektivisht, një pjesë e barrës së tranzicionit mbahet nga pensionistët dhe punonjësit më të moshuar – zakonisht në formën e moshave më të mëdha të daljes në pension dhe një indeksim pensioni më pak gjeneroz.

Madhësia e kolonës së dytë. Madhësia e kolonës së dytë varet nga objektivat dhe përfitimet e pritura prej reformës së pensioneve, si dhe nga kufizimet ekonomike dhe institucionale për arritjen e këtyre objektiveve. Kur fillohet të merret në shqyrtim futja e kolonës së dytë, ka nevojë të shpjegohen disa kufij fillestare për madhësinë e mundshme të saj dhe zgjedhja mund të bëhet mbi bazën e analizës së mëtejshme ekonomike dhe eksperiencës ndërkombëtare. Në këtë kuptim, bazuar në çfarë ka ndodhur në shumicën e vendeve në terma të marrëveshjeve institucionale, nuk këshillohet një kolonë e dytë me më pak se 3-6 % për shkak të koston së saj efektive. Asetet që shkojnë në kolonën e dytë duhen investuar në bazë të sinjaleve të tregut nëse konvertimi në sistemin e kapitalizuar është për të kontribuar në rritjen ekonomike të ardhshme. Eksperienca sugjeron që analiza duhet të nisë me një kufi të sipërm për përqindjen e kontributit për kolonën e dytë në rangun 7-10 % të pagës.

Mbledhja e kontributeve dhe administrimi i tyre. Mund të jetë një agjenci shtetërore që mbledh kontributet e kolonës së dytë, një mbajtës-rekordesh apo edhe

një agjent mbajtës-rekordesh dhe informues ekskluziv për pjesëmarrësit e fondit. Mbledhja e kontributeve është më e komplikuar në një sistem shumë kolonësh se sa në sistemin publik. Duhet realizuar mbledhja, regjistrimi dhe transferimi i kontributeve në llogaritë individuale.

c. Alternativa lidhur zhvillimin e një sistemi të plotë pensionesh.

Në këto kushte nuk mund të vazhdojmë që më poshtë të sjellim **opsione, të cilat përveç një kolone të dytë me përfshirje të gjerë, të mund të fokusohen në largimin nga sistemi i detyrueshëm, qoftë edhe një pjesë të punëmarrësve bazuar në grup moshat etj.** Megjithatë për efekte të diskutimit dhe të rrahjes e të tërheqjes së mendimeve, më poshtë evidentohen disa opsione si dhe efektet që ato do të kenë mbi skemën e detyrueshme lidhur me kostot e tranzicionit për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Llogaritjet mbi efektet janë bazuar në variante të studjuara më parë nga ISSH bazuar në kalkulimet e bëra me programe të posaçme apo edhe në përlllogaritje të drejtpërdrejta bazuar në gjendjen aktuale të pjesëmarrjes, normës së kontributeve, të të ardhurave etj.

- **Zgjerimi i fondeve profesionale të Sigurimeve Shoqërore**, si pjesë e kontratës së punës, bazuar në kontribute të përcaktuara, të ndara midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, totalisht e kapitalizuar, madhësia e përfitimeve varet nga kontributet dhe fitimet nga investimet ndërsa anuitetet dhe përfitimet mujore përlllogariten në mënyrë aktuariale bazuar në jetëgjatësinë në vitin përkatës, vlerën aktuale të depozitës si dhe fitimet e ardhshme të supozuara, të administruara nga subjekte profesionale të licensuara. Natyrisht që zhvillimi i këtyre fondeve në radhë të parë kërkon mbështetjen e Qeverisë, edhe në rolin e saj si punëdhënës dhe gjithashtu kërkon edhe mirëkuptimin dhe mbështetjen nga punëdhënësit qofshin këto kompani me kapital shtetëror, pjesërisht shtetëror apo me kapital privat. Zhvillimi i këtyre skemave do të krijonte mundësi për ti dhënë zgjidhje kërkesave për pensione të parakohshme të disa profesioneve, do të krijonte mundësi reale të raportit total të zëvendësimit midis pagës mesatare dhe shumës së pensioneve individuale mesatare të ishte më i pranueshëm dhe gradualisht në një periudhë afatmesme kursimet aktuale do të ndikonin në përmirësimin e konsumit, barra e shtetit për mbrojtjen sociale do të ishte më e ndarë dhe e bashkërenduar, duke lënë më shumë përgjegjësi edhe për vetë personin. Një problematikë e veçantë për Shqipërinë janë fushat e investimit të këtyre fondeve për shkak të një tregu financiar të pazhvilluar si dhe e uljes së kostove të administrimit të këtyre fondeve. Aktualisht legjislacioni egzistues është adekuat dhe krijon mundësitë për zhvillimin e tyre.

Vendosja e sistemit të detyrueshëm privat të pensioneve duke ndarë fillimisht (1.6-3) % të kontributit për skemat vetëkapitalizuese, nga ku (0.8 -1.5 %) punëdhënësi dhe (0,8 %-1.5 %) punëmarrësi. Ky variant mendohet se *“nuk shoqërohet me kosto financiare të ndjeshme”*, përkundrazi në

një prespektivë të afërt jo vetëm do të zgjidhë problemet e pensioneve, por edhe do të forcoj qëndrueshmërinë e sistemit të përgjithshëm të pensioneve edhe në Shqipëri. Megjithatë efektet financiare duhet të llogariten me qëllimin për të parë sa ndikon kjo ndarje në totalin e të ardhurave të destinuara për skemën e pensioneve si dhe në nevojën për një mbështetje buxhetore më të madhe, për sa kohë skema e pensioneve publike është deficitare. Bazuar në llogaritjet që sjell programi aktuarial prost, lidhur me demografinë, forcat e punës, pjesëmarrjen, kontribuesit, pagat mbi të cilën paguhen kontributet etj., disa supozime dhe rezultate paraprake do të kishin tendencat si më poshtë: Në harkun e dhjetë viteve bazuar në programet e punësimit, urbanizimin dhe luftën kundër informalitetit, numri i kontribuesve në qytet pritet të rritet me rreth 180 mijë persona duke arritur një pjesëmarrje prej 667 mijë persona (Prognoza të realizuara nga ISSH 2015); paga vjetore për efekt të pagesës së kontributit, për shkak të rritjes së PBB, ndryshimeve strukturore ekonomike e të pjesëmarrjes së forcave të punës sipas degëve, rentabilitetit të ekonomisë dhe reduktimit të informalitetit, parashikohet të rritet me rreth 34 %, afërsisht me ritmin e rritjes së PBB, aktualisht jemi në kufijtë e një page mesatare mujore prej 43 900 lekë. Në këto kushte në harkun e 10 viteve, ndarja nga kontributi i degës së pensioneve i një shume prej 1.6 – 3 % ndërsa do të grumbullonte në Fond një shumë kontributesh prej rreth 65 miliard lekë në rastin e parë dhe rreth 122 miliard lekë sipas zbritjes kontributive rasti i dytë, do të sillte një deficit të skemës PAYG në terma aftatgjata që varion nga + 0.3 deri në + 0.6 % të PBB ndërkohë që deficitin e skemës PYGO të reformuar në vitin 2025 edhe pa zbritjen e kontributeve parashikohet të jetë në jo më pak se 0,8 - 1 % e PBB (Projeksionet aktuariale të realizuara nga ISSH, 2015). Llogaritjet bazohen në një variant mesatarisht optimist të zhvillimit të treguesve. Nga ana tjetër një kontribut mujor prej 1,6 deri në 3 % për ata persona që do të kontribuonin jo më pak se 15 vite, me një normë fitimi mesatar vjetor mbi 7 %, do të mund të akumulonte bruto rreth 5 deri në 9 fishin e pagës mujore mbi të cilën llogaritet kontributi duke sjellë një rritje të shkallës së zëvendësimit nga skema PAYG nga 2.8 – 5 % (Projeksionet aktuariale të realizuara nga ISSH, 2015);. Ndërkohë sipas dispozitave aktuale edhe kosto e Administrimit do të ishte mjaft e lartë në raport me asetet dhe kjo natyrisht kërkon rishikim. **Sidoqoftë kjo mund të jetë një nismë, e cila ka efekte individuale shumë më të qënësishme kur llogaritjet bëhen për 25 deri në 30 vite kur mund të arrihej një përmirësim i shkallës së zëvendësimit me rreth 10 % ose mund të arriheshin pensione të parakohshme për kategori të veçanta profesionale me një shkallë zëvendësimi prej rreth 30 %** (Projeksionet aktuariale të realizuara nga ISSH, 2015);. Siç dihet dhe përse u analizua e evidentua edhe më lart, formula aktuale e pensionit është konstruktuar bazuar në parimin nocional pra në parimin e kthimit të kontributeve të derdhura gjatë periudhës së punës, në periudhën e pensionimit, këto natyrisht të rivleresuara. Ndarja nga skema aktuale e një përqindje të caktuar kontributi nuk do të

atakonte vetëm rritjen e pjesëmarrjes së buxhetit të shtetit për financimin e pensioneve aktuale, por mundet edhe të kërkonte edhe një rishikim të formulës së kalkulimit të masës fillestare të pensionit.

- **Ndarje e kontribuesve në dy pjesë;** Kontribuesit në moshën 35 e sipër do të jenë pjesë e shtyllës shtetërore ndërsa kontribuesit në moshën 35 e poshtë do të futen detyrimisht në shtyllën e dytë. Në mënyrë skematike skema do të mund të ketë këto parametra:

Tabela 1: Ndarja e kontribuesve

<i>Varianti c</i>	<i>Shtylla 1</i>	<i>Shtylla 2</i>	<i>Punëmarrësi</i>	<i>Punëdhënësi</i>	Pensioni
mbi 35 vjeç	21.6%		8.4%	13.2 %	I llogaritur me formulë si përfitim i përcaktuar
nën 35 vjeç		21.6%	8.4%	13.2 %	1. Pension privat 2. Njohje e të drejtave në PAYG


Burimi: Autori

Është zgjedhur mosha 35 vjeç si për meshkuj edhe për femrat që do të zhvendoset e gjitha në kolonën e dytë pasi kanë një historik të parëndësishëm në kolonën e parë ose mund të kenë një historik kontribuesh që i çon deri në nivelin e pensionit të pjesshëm të pleqërisë (pension mbijetese) dhe është supozuar që popullsia mbi moshën 35 do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG të reformuar. Gjithashtu në këtë variant presupozohet që të gjithë kontribuesit e rinj që hyjnë në skemë, pavarësisht nga mosha të jenë pjesë e kolonës së dytë.

Kontributet do të mbledhen dhe administrohen dhe për këtë pjesa e kontributit që shkon për shpenzime administrative në kolonën e dytë është parashikuar të jetë 3 % e totalit të kontributeve që derdhen në këtë kolonë në vitin e parë të futjes së kolonës së dytë dhe më pas ulet linearisht deri në 2 %, ndërsa pjesa e kontributeve që shkon për përfitime të tjera (përveç atyre të pleqërisë) përllogaritet të jetë rreth 2 % e pagës ose rreth 8 % të totalit të kontributeve të mbledhura. Interesi real i fituar nga llogaritë individuale është parashikuar të jetë sipas normave të tregut, por jo më pak se 5 % kur norma e inflacionit vjetor është 2.8 – 3 %.

Kalimi i një pjese të kontribuesve të skemës PAYG në kolonën e dytë do të thotë më pak kontribute për kolonën e parë. Në kolonën e parë tashmë ka më pak kontribues që duhet të mbështesin pensionistët aktual dhe të pritshëm për deri 12 vitet e ardhshme (2032). Duke patur parasysh gjithashtu që kontribuesit e rinj që i

bashkohen skemës së pensioneve do të jenë pjesë e kolonës së dytë, numri i kontribuesve në këtë skemë do të fillojë të ulet, ndërkohë që kontributi i personave të mbetur në sistemin PAYG bëhet gjithmonë e më shumë i pamjaftueshëm për të përballuar pagesat e pensionistëve aktual dhe të pjesëmarrësve të skemës, të cilët momentalisht janë kontribues, por do të jenë përfitues kur të kenë plotësuar kushtet për pension. Më poshtë gjendet një grafik i përafërt llogaritjesh ku lehtësisht mund të krahasohet rënia e të ardhurave të skemës PAYG, nga ky operacion (Projeksionet aktuariale të realizuara nga ISSH, 2015);.




Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 2015

Figura 1: Të ardhura e PYAG të reformuar

Kontribuesi më i ri në moshë që mbetet në kolonën e parë, në vitin 2016 është 36 vjeç. Atij do t'i duhet të kontribojë në skemë edhe për 29 vite të tjera deri sa të arrijë moshën për të dalë në pension. Kështu deri në vitin 2045 do të kemi persona që derdhin kontribute në këtë skemë. Më pas do të ketë vetëm përfitues. Kështu, skema PAYG do të vazhdojë ti paguajë përfitime personave që kanë qenë pjesë e saj deri rreth viteve 2064 – 2071. Nga ana tjetër, personat që kanë kontribuar për ca kohë në skemën PAYG dhe në vitin 2016 duke qenë nën moshën 35 vjeç kalojnë në kolonën e dytë, kanë disa të drejta të fituara në këtë skemë, bazuar në kontributet që ata kanë paguar kur kanë qenë pjesë e kësaj skeme.


Kështu shpenzimet për pensione pleqërie në skemën PAYG përbëhen nga shpenzimet për të paguar përfitimet e personave që janë pjesë e saj dhe shpenzime për të paguar të drejtat e fituara nga kjo skemë, të personave që tashmë janë pjesë e kolonës së dytë. Madhësia dhe tendenca e shpenzimeve parashihet si më poshtë:



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 2015

Figura 2: Shpenzimet për pension pleqërie e PYAG të reformuar

Siç shihet ato vinë duke u rritur deri në vitin 2048 ndërkohë që pas këtij viti si numri i përfituesve nga kjo skemë ashtu edhe masa e përfitimeve bie progresivisht. Në këto kushte balanca e skemës PAYG paraqitet si më poshtë: (Projeksionet aktuariale të realizuara nga ISSH, 2015);




Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 2015

Figura 3: Situata financiare në kolonën e PYAG të reformuar

Nga sa më sipër konkludohet për një kosto tranzicioni, e cila është mjaft e lartë që reflekton një sistem PYGO jo vetëm të pamjaftueshëm, por edhe deficitar në të gjithë periudhën e përllogaritur.

Një situatë krejtësisht të ndryshme financiare vëmë re në kolonën e dytë. Fillimisht do të ketë vetëm kontribute dhe shumë pak shpenzime. Ndërkohë, në këtë kolonë do të fillojnë të paguhet edhe pensione invaliditeti apo familjare dhe sigurisht do të ketë edhe shpenzime administrative. Megjithatë siç duket edhe grafiksht, shpenzimet në vitet e para të periudhës së parashikimit do të jenë të pakta, balanca do të jetë shumë pozitive duke sjellë një situatë financiare të favorshme dhe krijuar mundësinë e investimit të një pjese të madhe të të ardhurave (Projeksionet aktuariale të realizuara nga ISSH, 2015);.



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 2015

Figura 4: Situata financiare në kolonën e Funded DC

Shihet një rritje e ndjeshme e shpenzimeve rreth viteve 2044 – 2054, periudhë në të cilën kontribuesit që në vitin 2016 ishin nën moshën 35 vjeç plotësojnë kushtet për përfitim pleqërie. Pikërisht në këtë periudhë fillon të rritet edhe shkalla e zëvendësimit e përfituesve nga kolona e dytë.

5. Konkluzione dhe rekomandime

Presionet demografike si rënia e lindshmërisë, rritja e jetëgjatësisë së qytetarëve, emigracioni masiv i kraut të punës si dhe problemet ekonomike në nivel strukturor në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë do të krijojnë një vështirësi në skemën publike të pensioneve.

Vështirësitë do të jenë në dy kahe, në deficitin e madh të skemës publike duke rrezikuar qëndrueshmërinë financiare të skemës dhe në shkallën e ulët të zëvendësimit për përfituesit. Masa e pensionit do të jetë e ulët duke mos garantuar qëllimin e ekzistencës së skemave të pensionit, zëvendësimin e të ardhurave nga puna dhe zbutjen e varfërisë në moshën e tretë.

Një opsion i shmangies së këtyre vështirësive dhe presioneve është diversifikimi i mbrojtjes nëpërmjet disa instrumentave gjë që diversifikon edhe rriskun strukturor, por edhe personal të individit.

Ky diversifikim realizohet nëpërmjet sistemit shumë kolonësh dhe në kontekstin shqiptar krijimi i kolonës së dytë me kontribut të përcaktuar dhe të kapitalizuar.

A është gati Shqipëria për një reformë të tillë? Mendimi ynë është që duhet filluar ndërtimi i kësaj kolone qoftë edhe me një normë kontributi të ulët me qëllim edukimin e njerzve që rrisku duhet të shpërndahet dhe mbajtur nga secili, përfitimi i eksperiencës dhe krijimi i strukturave përkatëse monitoruese, krijimi i tregut të investimeve të kapitalit, rritja e kursimeve personale dhe në shkallë kombëtare duke u bërë një motor i ngritjes së ekonomisë si dhe rritja e shkallës së zëvendësimit të të ardhurave.

A duhet financiar kjo kolonë nga norma aktuale kontributive që shkon e gjitha për kolonën e parë publike apo nëpërmjet një kontributi shtesë, gjykimi yne është që në fazat e para nuk duhet të preket norma kontributive e kolonës së parë dhe të financohet nga një kontribut shtesë e ndarë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe ndoshta nga të punësuar në ato degë të ekonomisë që kanë produktivitet të lartë dhe paga të larta dhe në vazhdimësi përfshirja e të gjithë të punësuarve dhe të vetëpunësuarve në skemë.

7. References

The Inverting Pyramid “Pension Systems facing demographic challenges in Europe and Central Asia”, Anita M. Schwarz, Omar S. Arias, World Bank
<http://www.worldbank.org/content/dam/worldbank/Feature%20Story/ECA/EC A-Pensions-Report-2014.pdf>

World Bank, 1994, Averting the Old Age Crisis (New York, Oxford Press University)

Barr, Nicholas and Peter Diamond. 2009. “Reforming Pensions: Principles, Analytical Errors and Policy Directions.” International Social Security Review.

Vittas, Dimitri, Heinz P. Rudolph, and John Pollner. 2010. “Designing the Payout Phase of Funded Pension Pillars in Central and Eastern European Countries.” Policy Research Working Paper 5276, World Bank, Washington, DC

Schwarz, Anita. 2011. “New Realities of Pension Policy in Central Europe.” Human Development Group, Europe and Central Asia Region, World Bank, Washington, DC. http://ebrd.com/english/downloads/research/news/Schwarz_paper.pdf

Whitehouse, Edward R., Anna D’Addio, Rafal Chomik, and Andrew Reilly. 2009. “Two Decades of Pension Reform: What has Been Achieved and What Remains to be Done?” Geneva Papers on Risk & Insurance—Issues & Practice 34:

Holzmann, Robert, and Edëard Palmer, eds. 2006. Pension Reform: Issues and Prospects for Non-Financial Defined Contribution (NDC) Schemes. Washington, DC: World Bank

“Social Policy in Central and Eastern Europe”, Alfio Cerami, Lit Verlag, Berlin 2006

https://books.google.al/books?id=MJdWGKl2iAC&pg=PA102&lpg=PA102&dq=hungary+social+insurance+scheme+second+pillar+report&source=bl&ots=NëFzLxFDio&sig=S0GdPpKuZF-ibiHC3f_P_hzikuI&hl=sq&sa=X&ved=0CDcQ6AEëBëoVChMIusKDqv6gyAIVQ1WUCh25-QAd#v=onepage&q=hungary%20social%20insurance%20scheme%20second%20pillar%20report&f=false

Central & Eastern Europe: Another odd one out, article January 2014 (Magazine)

By Barbara Ottawa <http://www.ipe.com/pensions/pensions-in/central-and-eastern-europe-another-odd-one-out/10000687.article>

Pension reform in Slovakia: “The context of economic globalization” Ivan Lesay, European Trade Union Institute for Research, Education and Health and Safety (ETUI-REHS) Brussels, November 2006

https://scholar.google.com/scholar?q=Pension+reform+in+Slovakia:+the+context+of+economic+globalization&hl=en&as_sdt=0&as_vis=1&oi=scholart&sa=X&ved=0CCEQgQMëAGoVChMIoO2DuO2yyAIVibëUCh0_9gi5

International Update: Recent Development in Foreign Public and Private Pensions

http://www.ssa.gov/policy/docs/progdsc/intl_update/2015-03/2015-03.pdf

Inception Report on Target Social Assistance Scheme, Decent Work: Integrated Approach to Social Sphere in Kazakhstan, International Labour Office (ILO) - Subregional office for Eastern Europe and Central Asia - UNDP Country Office in the Republic of Kazakhstan

<http://www.ilo.org/public/english/bureau/dëpp/doënload/kazakhstan/kazsocsoclist.pdf>

Are Second Pillar Pensions Robust in the Face of Economic Shocks?

<http://blogs.worldbank.org/futuredevelopment/are-second-pillar-pensions-robust-face-economic-shocks>